
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 15.04.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE MATERIALE PËR LABORATORIN E
RESTAURIMIT DHE TESTIMEVE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Reagente laborator 33696500-0; Reagente kimik 3369300-8; Pajisje te ndryshme 39300000-5; Acid sulfurik 24311411-1; Alkool etilik 24322510-5; Leter arti dhe artizanale 37823500-8; Leter filtra 15994200-4; Pipeta 38437100-8; Pambuk 03115110-4; Shishe 39225710-5; Gershere 39241200-5; Amoniak 24413000-2; Bisturi dhe the mbrehte 33141411-4; Doreza njeperdorimshe 18424300-0

**MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK, KU TË GJITHA KUSHTET
JANË TË PËRCAKTUARA**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër është 7,218,519.4 (shtatë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqindë e nëntëmbëdhjetë pikë katër) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë : c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme .”

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 55 pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 55 pika 4/b VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme çka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike ose katalog teknik ose skedë sigurie ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori për artikujt me numër rendor nga nr.1, nr.2, nr.4 e deri në nr.24. Për artikujt me numër rendor nr.3, nr.25 e deri në nr. 105 duhet të paraqitet skedë teknike ose katalog teknik ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori. Në dokumentacionin si më sipër kërkuar, duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikujve të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën e Laboratorin e Restaurimit dhe Testimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog teknik/ skedë tëknike/skede sigurie ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi i mallit. Në rast se ofertuesi do të sigurojë mallin nga distributori i autorizuar, duhet të paraqesë dokumentacionin teknik të prodhuesit që autorizon distributorin për tregtimin e mallrave të tij. Gjithashtu katalog teknik/ skedë tëknike/skede sigurie ose dokumentacion teknik ekuivalent do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

-ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

-ISO 14001 “Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit” (e vlefshme) ose ekuivalent;

-ISO 45001 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” (e vlefshme) ose ekuivalent.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbeshtetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.” Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të stafit, nisur nga vetë natyra e mallrave objekt prokurimi, ku disa prej tyre shkaktojnë dëme si në mjedis ashtu edhe në shëndetin e punonjësve.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK, nisur nga lloji i mallrave objekt prokurimi, vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se operatori ekonomik gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Kjo qasje proaktive ndaj menaxhimit mjedisor mund të rezultojë në përfitime të prekshme, të tilla si reduktimi i mbetjeve, ruajtjes së energjisë dhe kursimeve të kostos.

ISO 45001 ose ekuivalent është një standard ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai siguron një kornizë për organizatat për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën. Përfitimet e këtij kualifikimi; Kuadri për të menaxhuar në mënyrë sistematike rreziqet; Ulja e incidenteve dhe lëndimeve në vendin e punës; Përkushtim i demonstruar për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve.

Për sa më sipër, certifikimet e kërkuara janë të lidhura ndushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me mallrat objekt prokurimi.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i skadencës së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Nisur nga malli objekt prokurimi, furnizim me materiale të ndryshme konsumi mjekësore dhe referuar shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, në specifikimet teknike janë parashikuar afatet e skadencës për mallrat objekt prokurimi nga momenti dorëzimit në Autoritetin kontraktor. Me anë të këtij kriteri kërkohet që t’i ofrohet siguri Autoritetit Kontraktor përfitues mbi afatin e skadencës së mallave që kërkohen. Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ky kriter është në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi I specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të

produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor Përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si më poshtë vijon:

Specifikimi i Materialeve:

Nr	Emërtimi i artikujve	Specifikimet teknike
1	Alkol etilik transparent pa ngjyre	Alkol etilik me pastërti 90%, përqendrimi i alkoolit etilik është përcaktuar për të garantuar efikasitet në pastrim dhe dezinfektim, duke minimizuar njëkohësisht ndikimin e lagështisë mbi materialet arkivore dhe duke siguruar kontroll gjatë ndërhyrjeve restauruese. Afati i skadencës jo më pak se 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Materiali i ambalazhit të jetë HDPE (High Density Polyethylene) ekuivalent material plastik rezistent ndaj kimikateve, i fortë, i lehtë dhe i pajisur me kapak sigurie, me vëllim neto 1 litër. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, pastërtinë, datën e prodhimit, afatin e përdorimit, simbolin e rrezikut dhe udhëzimet e sigurisë. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
2	Solvent sapun per larje dokumentash	Përbërja kimike potassium methyl cyclohexyl oleate. Afati i skadencës jo më pak se 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Formati shishe 500ml. Materiali i ambalazhit: HDPE (High Density Polyethylene) ekuivalent material plastik me kapak sigurie. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, përbërjen, datën e prodhimit, udhëzimet e hollimit. Reaktiviteti kimik inert ndaj pigmentit, bojës dhe substratit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
3	Hidroksid calcium	Formati: 1 kg, gjëndja e ngurtë (pluhur i bardhë). Pastërtia $\geq 96\%$ për përdorim laboratorik. Afati i skadencës jo më pak se 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Materiali i ambalazhit: HDPE (High Density Polyethylene) ekuivalent material plastik me kapak sigurie dhe mbrojtje ndaj lagështisë. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, pastërtinë, datën e prodhimit, simbolin e rrezikut, udhëzimet e përdorimit. Produkti

		të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
4	Spraj deacidifikimi ne forme aerosol	Formati i produktit shishe jo më pak se 500 ml. Materiali i ambalazhit alumini ose plastike e presuar me valvul sigurie. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, përbërjen, udhëzimet e përdorimit, simbolin e rrezikut, datën e prodhimit dhe numrin e lotit, afatin e përdorimit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë (SDS/MSDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
5	Pluhur aditiv për heqjen mbishtrësive (ngjitësa)	Pluhur aditiv me përberje kimike silikat sintetik i natriumit, litiumit dhe magnezit ose ekuivalent funksional për largim të kontrolluar dhe selektiv të shtresave ngjitëse, pa dëmtuar fibrat e letrës apo bojërat. Numri CAS 53320-86-8. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Formatimi i produktit të jetë në kova pastike ose analoge jo më shumë se 1kg. Materiali i ambalazhit të jetë PE ose kuti kartoni, rezistente ndaj lagështisë, duke garantuar mbrojtje të sigurt të materialeve gjatë ruajtjes dhe transportit. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, numrin e lotit, datën e prodhimit, afatin e përdorimit, simbolin e rrezikut dhe udhëzimet e ruajtjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
6	NaOH (substance e ngurtë)	Formula kimike NaOH. Numri CAS 1310-73-2(është numër unik ndërkombëtar që ka produkti). Pastërtia $\geq 98\%$ në funksion të përdorimit laboratorik. Forma kristale të bardha (e ngurtë). Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Paketimi të jetë HDPE (High Density Polyethylene) ekuivalent material plastik dhe i etiketuar sipas rregullave të sigurisë kimike, rezistente ndaj bazave, me kapak sigurie, kapaciteti 500 g NaOH. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
7	E kuqe metil	Formula kimike $C_{15}H_{15}N_3O_2$. Numri CAS 493-52-7 (është numër unik ndërkombëtar që ka produkti). Forma fizike pluhur kristalor. Pastërtia $\geq 99\%$ në funksion të përdorimit laboratorik (analytical grade / p.a.). Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi të jetë në enë qelqi të errët, hermetike, me kapak sigurie. Paketimi të jetë 1 enë me e kuqe metil (100g), të përfshijë fletën me të dhënat e sigurisë dhe certifikatën e pastërtisë. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.

8	Solucion puferik 4.01	Forma fizike lëng transparent, pa ngjyrë. Temperatura e përdorimit 5°C – 35°C. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi 100ml, e mbyllur hermetikisht. Etiketimi të tregoj vlerën e pH, temperatura referencë, numri i lotit, data e skadencës. Tabelë temperaturë vs pH për kompensim termik. Produkti të shoqërohet me Certifikatë Analize (COA) ose dokumentacion gjurmueshmërie ekuivalent, si dhe me Skedë Sigurie ose Skedë Teknike.
9	Solucion puferik 7.01	Forma fizike lëng transparent, pa ngjyrë. Temperatura e përdorimit 5°C – 35°C. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi 100ml, e mbyllur hermetikisht. Etiketimi të tregoj vlerën e pH, temperatura referencë, numri i lotit, data e skadencës. Tabelë temperaturë vs pH për kompensim termik. Produkti të shoqërohet me Certifikatë Analize (COA) ose dokumentacion gjurmueshmërie ekuivalent, si dhe me Skedë Sigurie ose Skedë Teknike.
10	Solucion puferik 10.01	Forma fizike lëng transparent, pa ngjyrë. Temperatura e përdorimit 5°C – 35°C. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi 100ml, e mbyllur hermetikisht. Etiketimi të tregoj vlerën e pH, temperatura referencë, numri i lotit, data e skadencës. Tabelë temperaturë vs pH për kompensim termik. Produkti të shoqërohet me Certifikatë Analize (COA) ose dokumentacion gjurmueshmërie ekuivalent, si dhe me Skedë Sigurie ose Skedë Teknike.
11	Solucion puferik 14.01	Forma fizike lëng transparent, pa ngjyrë. Temperatura e përdorimit 5°C – 35°C. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi 100ml, e mbyllur hermetikisht. Etiketimi të tregoj vlerën e pH, temperatura referencë, numri i lotit, data e skadencës. Tabelë temperaturë vs pH për kompensim termik. Produkti të shoqërohet me Certifikatë Analize (COA) ose dokumentacion gjurmueshmërie ekuivalent, si dhe me Skedë Sigurie ose Skedë Teknike.
12	Solucion pastrues dhe denzifektues për elektrodën e pH- metër	Forma fizike tretësirë transparente. pH i tretësirës (6.0-7.5). Solucion i sigurt për elektroda me membrana qelqi. Paketimi të përfshijë 1 enë 100ml solucion pastrues dhe dezinfektues për elektrodë pH, udhëzuesin për përdorim, pastrim dhe ruajtje. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketa të përmbajë numrin e lotit, datën e skadencës dhe përbërjen. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
13	Solucioni pastrues për elektroda pH metër	Forma fizike tretësirë transparente. pH i tretësirës (2.0 – 3.0). Solucion i sigurt për elektroda me membrana qelqi. Paketimi të përfshijë 1 enë 100ml solucion pastrues për elektrodë pH, udhëzuesin për përdorim, pastrim dhe ruajtje laboratorike. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketa të përmbajë numrin e lotit, datën e skadencës dhe përbërjen. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.

14	Solucioni për ruajtjen e elektrodave (pH)	Forma fizike tretësirë transparente, pa ngjyrë. Përbërja kimike Klorur kaliumi (KCl) 3 M ±0.2 M. pH i tretësirës (pH ~7.0). Solucion i sigurt për elektroda me membrana qelqi. Ambalazhimi të jetë në enë plastike të errëta ose ekuivalente, hermetike, 100ml. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të përmbajë numrin e lotit, datën e skadencës, përbërjen dhe udhëzimin për përdorim. Paketimi të përfshijë 1 enë 100ml. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
15	Klorur kaliumi (KCL)	Formula kimike KCl. Forma fizike kristale të bardha, pa erë. Pastërtia ≥99.5% në funksion të përdorimit laboratorik (shkallë analitike). Masa molare 74.55 g/mol në funksion të përdorimit laboratorik. Ambalazhimi të jetë në enë plastike hermetike, të errëta, 500 g. Etiketimi të përmbajë emrin kimik, formulën, pastërtin, numrin e lotit dhe datën e skadencës. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
16	Acid sulfurik (H2SO4)	Formula kimike H ₂ SO ₄ . Forma fizike tretësirë transparente. Pastërtia ≥95–98% në funksion të përdorimit laboratorik (shkallë Analitike). Dendësia ~1.84 g/cm ³ në 20°C. Ambalazhimi në enë qelqi të errëta 1l. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të ketë emrin kimik, formulën, përqendrimin, numrin e lotit, datën e skadencës dhe piktogramet e rrezikut. Përfshirje në Paketim: Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
17	Jodur kaliumi (KI)	Formula kimike KI. Forma fizike kristale të bardha, pa erë. Pastërtia ≥99.0% në funksion të përdorimit laboratorik. Masa molare 166.00 g/mol. Ambalazhimi të jetë në enë plastike HDPE hermetike, të errëta, 1 kg. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të ketë emrin kimik, formulën, përqendrimin, numrin e lotit, datën e skadencës dhe piktogramet e rrezikut. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.

18	Permanganat kaliumi (KMnO ₄)	Formula kimike KMnO ₄ . Forma fizike kristale të errëta vjollcë ose kafë-vjollcë, pa erë. Pastërtia ≥99.0% në funksion të përdorimit laboratorik. Ambalazhimi të jetë në enë plastike HDPE hermetike, të errëta, 500g. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të ketë emrin kimik, formulën, përqendrimin, numrin e lotit, datën e skadencës dhe piktogramet e rrezikut. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributor.
19	Tiosulfat natriumi (Na ₂ S ₂ O ₃)	Formula kimike Na ₂ S ₂ O ₃ ·5H ₂ O (forma pentahidrate). Forma fizike kristale të bardha ose pak të hirtë, pa erë. Pastërtia ≥99.0% në funksion të përdorimit laboratorik. Masa molare 248.18 g/mol (pentahidrate). Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Ambalazhimi të jetë në enë plastike HDPE hermetike, të errëta, 1 kg. Etiketimi të ketë emrin kimik, formulën, përqendrimin, numrin e lotit, datën e skadencës dhe piktogramet e rrezikut. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Fletë të dhënash për sigurinë. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
20	Aceton	Formula kimike CH ₃ COCH ₃ (C ₃ H ₆ O). Pastërtia ≥99.5% në funksion të përdorimit laboratorik. Forma fizike lëng transparent, pa ngjyrë, me erë karakteristike. Ambalazhimi në enë qelqi të errët, hermetike, 1 l. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të përfshijë emrin kimik, formulën, pastërtin, numrin e lotit, datën e skadencës, piktogramet e rrezikut. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit. Fletë të dhënash për sigurinë. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
21	Ngjitës metil celulozë	Forma fizike: pluhur i bardhë, pa erë. Pastërtia ≥99% në funksion të përdorimit laboratorik. I tretshëm në ujë. Ambalazhimi në enë plastike hermetike, 100 g. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Etiketimi të përfshijë emrin e produktit, formulën, viskozitetin, numrin e lotit, datën e skadencës. Paketimi individual 1 x 100g metil celulozë pluhur. Udhëzuesin për përgatitjen e tretësirës

		ngjitëse. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike ose Skedë të Sigurisë, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
22	Amoniak	Formula kimike NH_4OH . CAS Nr.1336-21-6. Pastërti $\geq 99.8\%$ në funksion të përdorimit laboratorik. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të jetë i ambalazhuar në enë rezistente ndaj substancave korrozive (p.sh. HDPE ose material ekuivalent), me mbyllje hermetike dhe paketim të përshtatshëm për transport të sigurt, në mënyrë që të shmangen rrjedhjet, dëmtimet dhe ekspozimi gjatë transportit dhe dorëzimit Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS) ose Skedë të Sigurisë (SDS/MSDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
23	Ngjitës karboksimetil celuloze	Formula kimike $\text{C}_6\text{H}_7\text{O}_2(\text{OH})_2\text{CH}_2\text{COONa}$, CAS Nr.9004-32-4 (është numër unik ndërkombëtar që ka produkti) i tretshëm në ujë, i përdorur për restaurim dokumentesh. Forma fizike pluhur i bardhë. Paketimi 100g. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e kërkesave funksionale të punës restauruese dhe laboratorike. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS) ose Skedë të Sigurisë (SDS/MSDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
24	Ngjitës hidroksipropil celulozë (HPC)	Formula kimike $[\text{C}_6\text{H}_7\text{O}_2(\text{OH})_{3-x}(\text{OCH}_2\text{CH}(\text{OH})\text{CH}_3)_x]_n$. CAS Nr. 9004-64-2 (është numër unik ndërkombëtar që ka produkti). Forma fizike pluhur i bardhë. Paketimi 100g. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS) ose Skedë të Sigurisë (SDS/MSDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
25	Peroksid hidrogjeni	Formula kimike H_2O_2 . Përqendrimi 50% në funksion të përdorimit laboratorik. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Paketimi të jetë në enë plastike HDPE të errëta ose ekuivalente, të mbyllura hermetikisht. Paketim 1l. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
26	Bojra akrilike	Formati tubeta jo më pak se 20 ml. Pigment natyral. Paketimi të përfshijë set bojërash akrilike jo më pak se 12 copë/pako. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS), ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributor.
27	Pambuk	Pambuk pastertia 100% për të garantuar mungesën e aditivëve kimikë dhe fibrave sintetike, duke siguruar neutralitet kimik. Stabiliteti e qëndrueshme për 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes Produkti të

		jetë i ambalazhuar në qese plastike ose kuti kartoni 100g të mbyllura hermetikisht. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, datën e prodhimit, numrin e lotit, afatin e përdorimit dhe udhëzimet e ruajtjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
28	Maska pluhuri	Numri i shtresave jo më pak se 3 (shtresë e jashtme, filtruese, e brendshme). Maskat kërkohen të jenë të prodhuara nga polipropilen, pasi ky material siguron filtrimin e grimcave, është inert kimikisht, rezistent ndaj lagështisë dhe i sigurt për përdorim laboratorik. Materiali i shtresës së jashtme polipropilen ose ekuivalent i tij. Materiali filtrues polipropilen melt-blown ose ekuivalent i tij. Materiali i shtresës së brendshme polipropilen e butë për kontakt me lëkurën ose ekuivalent i tij. Efikasiteti i filtrimit bakterial jo më pak se (BFE) \geq 98% në funksion të përdorimit laboratorik. Fiksimi me llastik pas veshëve dhe tel për hundën. Ngjyra blu në anën e jashtme për të dalluar të bardhë nga ana e brendshme. Madhësia 17.5 \times 9.5 cm (standard për të rritur). Formati: pako jo më pak se 50 copë, të mbyllura hermetikisht. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Materiali i ambalazhit: Qese PE ose kuti kartoni me mbrojtje ndaj lagështisë. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
29	Dorashka nitrile	Josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes.
30	Dorashka latex	Josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes.
31	Thes pastrimi gome	Një mjet manual i krijuar për pastrimin e sipërfaqeve të letrës, veçanërisht dokumenteve arkivore, dorëshkrimeve, librave të vjetër dhe materialeve të ndjeshme. Përdoret për të hequr papastërtitë sipërfaqësore, pluhurin, njollat e lehta dhe mbetjet pa dëmtuar fibrat celulozike. Pad-I (jastëk pastrues) është i përbërë nga materiale të buta, jo gërryese, dhe mund të jetë i mbushur me pluhur pastrues të kontrolluar. Përbërja e jashtme të jetë i përbërë nga fibra sintetike të butë (poliester ose pambuk i përpunuar). Mbushja e brendshme të jetë e përbërë nga pluhur pastrues i mikronizuar (goma natyrale, silikate të buta). Formati të jetë njësi individuale(copë) përmasat afërsisht 125x40x40. Materiali i ambalazhit të jetë në qese PE ose kuti kartoni të mbyllura hermetikisht. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, përbërjen, datën e prodhimit, udhëzimet e përdorimit. Afati i skadencës jo më pak

		24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
32	Filtra sintetik për larje dokumentash	Përbërja fibra poliesteri/ polietileni. Formatit i produktit rulon me gjerësi jo më pak se 100 cm. Materiali i ambalazhit të jetë në qese PE ose kuti kartoni me mbrojtje ndaj lagështisë. Etiketa të përmbaj emrin e produktit, përbërjen, datën e prodhimit, udhëzimet e përdorimit. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
33	Pluhur pastrimi gome	Përbërja jo më pak se 98% goma natyrale pa aditivë në funksion të përdorimit laboratorik. Forma fizike pluhur mikronizuar, granulim i imët. Ngjyra: e verdhë e lehtë ose bezhë natyrale. Reaktiviteti kimik: inert ndaj bojës, letrës dhe pigmentit. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
34	Karton për tharjen e dokumentave	Formati i produktit të jetë fletë të sheshta me përmasa jo më pak se 80x120cm. Përbërja të jetë 100%, fibra celulozike pa acide në funksion të përdorimit laboratorik për të garantuar mungesën e aditivëve kimikë. Reaktiviteti kimik inert ndaj bojës dhe pigmentit. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike (TDS) ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
35	Qese pluhurash (për makinerinë e thithjes së pluhurave)	Qese pluhurash formati të jetë i përshtatshëm për fshesë me korrent shërbimi ESD tipi 555 ESD-S GS fuqia 880 W. Materiali i ambalazhit: Qese PE. Materiali të jetë mikrofibër sintetik Polipropilen (PP) ose polietilen (PE) ose letër e përforcuar. Afati i skadencës jo më pak 24 muaj (e pa hapur); 3–6 muaj pas hapjes. Produkti të shoqërohet me Skedë Teknike, ose dokumentacion teknik ekuivalent nga prodhuesi/distributori.
